

Intervistë me Sekretaren e Përgjithshme të RCC-së Majlinda Bregu për Connecting the Region

Potencial i madh për bashkëpunim

Pavarësisht sfidave, rajoni i Ballkanit Perëndimor duhet të angazhohet me vendosmëri për tranzicionin e gjelbër, pasi kthimi prapa nuk është i qëndrueshëm kur bëhet fjalë për sigurinë e energjisë ose mirëqenien mjedisore.

Kuptimi i plotë i Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (GAWB), e cila është e ngjashme me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, është thelbësor për udhëtimin e rajonit tonë drejt rritjes së qëndrueshme dhe neutralitetit klimatik, thotë Sekretarja e Përgjithshme e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, Majlinda Bregu. “Veprimi i përbashkët” është thelbësor kur bëhet fjalë për afrimin e Ballkanit Perëndimor me këtë qëllim.

Kur diskutoni për Ballkanin Perëndimor, ju shpesh theksoni praninë e një “zone të gjerë veprimi të përbashkët” në rajon, kryesisht në fushën e ekonomisë. Në cilat fusha ky pohim ka rezultuar të jetë më i rëndësishëm deri më sot?

— Në Ballkanin Perëndimor, i cili është një rajon me rreth 18 milionë banorë të fragmentuar në gjashtë tregje më të vogla, koncepti i “veprimit të përbashkët” nuk është vetëm i arsyeshëm, por i vetmi koncept i zbatueshëm nëse duam të jemi konkurrues në tregun e përbashkët të BE-së, por gjithashtu edhe globalisht. Kur bëhet fjalë për fushën ekonomike, Plani i Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal (CRM), të cilin RCC-ja po e lehtëson dhe koordinon, ka bërë përparime të rëndësishme në fusha të shumta.

Arritjet më të dukshme janë marrëveshjet novatore të lëvizshmërisë, të cilat nxisin një treg dinamik dhe të ndërlidhur rajonal të punës, sepse pa fluksin e lirë të njerëzve – për të udhëtuar, studiuar dhe punuar – shoqëruar me fluksin e lirë të mallrave dhe kapitalit, nuk ka treg të përbashkët. Për më tepër, përpjekjet bashkëpunuese që synojnë avancimin

e reformave të politikave të investimeve, të tilla si miratimi i standardeve rajonale për negocimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare të Investimeve dhe përpjekjet e përbashkëta për nxitjen e investimeve, duke përfshirë mbështetjen për pjesëmarrjen në aktivitetet e gjenerimit të investitorëve, kanë shërbyer si katalizator për rritjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta në rajon, të cilat u rritën me pothuajse 40% gjatë viteve të fundit, duke arritur një rekord prej 8.7 miliardë eurosh në vitin 2022.

Për më tepër, përdorimi i korsive të gjelbra përfaqëson një tjetër sukses, duke rritur lehtësimin e tregtisë përmes shkurtimit të ndjeshëm të kohës së pritjes në pikat kufitare – duke kursyer gjithsej mbi 77,440 orë, ose më shumë se 3,200 ditë. Për më tepër, ekonomitë e rajonit kanë bashkëpunuar në mënyrë efektive për t'iu afruar Zonës së Vetme të Pagesave në Euro (SEPA), duke synuar që transaksionet e pagesave të jenë sa më të shpejta dhe me kosto efektive brenda ekonomive, sepse SEPA mund të gjenerojë përfitime vjetore deri në 500 milionë euro.

Këto janë vetëm disa shembuj midis shumë shembujve të tjerë që theksojnë praninë e veprimit të përbashkët dhe nënvizojnë potencialin e madh për një bashkëpunim të tillë në sferën ekonomike të Ballkanit Perëndimor. Aktualisht jemi duke përgatitur CRM 2, i cili do të bazohet te arritjet ekzistuese dhe edhe më shumë në veprimet e mëtejshme, në mënyrë që rajoni më pas të jetë në gjendje që gradualisht të hyjë në Tregun e Vetëm Evropian.

Sa të përgatitura janë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor për tranzicionin energjetik dhe përparimin ekonomik në përputhje me Marrëveshjen e Gjelbër të BE-së? A mund të realizohet ky tranzicion, i cili shihet se kërkon burime të konsiderueshme, pa mbështetjen e BE-së?

— Një kuptim i thellë i Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (GAWB), e cila është e ngjashme me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, është thelbësor për udhëtimin e rajonit tonë drejt rritjes së qëndrueshme dhe neutralitetit klimatik.

Pavarësisht objektivit për arritjen e neutralitetit klimatik deri në vitin 2030, rajoni përballet me sfida të tilla si infrastruktura e vjetruar, varësia nga qymyri dhe kufizimet ekonomike, duke na kushtuar mijëra jetë dhe nga 6 deri në 11 miliardë euro në vit.

Tranzicioni i energjisë është shumëplanësh dhe përfshin uljen e emetimeve të karbonit, promovimin e burimeve të rinovueshme dhe efikasitetin e energjisë, si dhe heqjen graduale të karburanteve fosile. Nevojat financiare prej 30 miliardë eurosh të vlerësuara nga BERZH-i për tranzicionin energjetik të rajonit deri në vitin 2030 qartësojnë sa e madhe është kjo detyrë.

Aktualisht jemi në procesin e përgatitjes së CRM 2, i cili do të bazohet te arritjet ekzistuese dhe do të ndër marrë veprime të mëtejshme për të lehtësuar kalimin e rajonit në Tregun e Vetëm Evropian.

Paketa prej 1.8 miliardë eurosh e BE-së për Mbështetjen e Energjisë dhe Plani i Rritjes prej 6 miliardë eurosh i japin përparësi dekarbonizimit dhe sigurojnë fondet bazë. Megjithatë, afërsisht 52% e investimeve duhet të synojnë burimet e rinovueshme me kosto konkurruese, kryesisht të financuara nga sektori privat, ndërsa 42% pritet të financohen nga qeveritë, investimet private dhe bankat e zhvillimit shumëpalësh.

Bashkëpunimi i fortë me strategji të informuara midis të gjithë aktorëve është thelbësor, me integrimin e hershëm në politikat përkatëse dhe përafrimin me standardet e BE-së, në mënyrë që të kapërcehet hendeku i konvergjencës dhe të sigurohet një e ardhme e qëndrueshme për Ballkanin Perëndimor. Pavarësisht sfidave, rajoni duhet të mbetet i përkushtuar ndaj tranzicionit të gjelbër, pasi kthimi prapa nuk i shërben as sigurisë së energjisë dhe as qëndrueshmërisë mjedisore.

Hulumtimi mbi qëndrimet e qytetarëve të Ballkanit Perëndimor, i kryer rregullisht për nevojat e RCC-së, ka treguar shqetësimet e tyre në lidhje me korrupsionin dhe krimin. Sa vendimtare janë institucionet e forta dhe shteti i së drejtës për zbatimin me sukses të këtyre reformave?

- Çështja kryesore këtu është besimi. Njerëzit në rajonin tonë nuk kanë një nivel të lartë besimi në institucionet e tyre. Sipas sondazhit tonë vjetor të Barometrit Ballkanik, mosbesimi më i lartë është ndaj partive politike, me 75%, i ndjekur nga afër nga mosbesimi te gjyqësori, me 69%, qeveria dhe media, të dyja me 62%, dhe institucionet e zbatimit të ligjit, me 61%. Pra, mosbesimi është i jashtëzakonshëm, çka përbën një tregues edhe në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit që u publikua së fundmi, ku të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor renditen lart në listë. Edhe pse ky indeks nuk

përfaqëson nivelin aktual të korrupsionit, i cili mund të jetë më i lartë ose më i ulët, perceptimi i korrupsionit është ende i lartë.

Barometri Ballkanik tregon se, vit pas viti, korrupsioni – së bashku me situatën ekonomike dhe papunësinë – mbetet ndër tre shqetësimet kryesore të qytetarëve tanë. Për më tepër, 55% e qytetarëve besojnë se korrupsioni është rritur. Gjejmë një situatë të ngjashme sa i takon perceptimit për krimin, ku 60% e qytetarëve e renditin krimin e organizuar si shqetësimin kryesor të sigurisë. Ky mosbesim, të cilin ne e kemi ndjekur për gati një dekadë përmes sondazheve tona të opinionit publik të Barometrit Ballkanik dhe SecuriMeter, nuk tregon shenja uljeje, në fakt krejt e kundërta është e vërtetë.

Korrupsioni dhe krimi minojnë vlerat thelbësore demokratike, duke ushtruar ndikime serioze mbi shtetin e së drejtës, stabilitetin ekonomik, drejtësinë sociale dhe zhvillimin e përgjithshëm dhe aspiratat për anëtarësim në BE të rajonit tonë. Për rrjedhojë, institucionet e forta që kanë integritet dhe llogaridhënie, dhe qëndrojnë të përkushtuara për të mbështetur shtetin e së drejtës dhe për të promovuar transparencën dhe qeverisjen e mirë, janë vendimtare për ofrimin e përgjigjeve të përshtatshme për luftimin e korrupsionit dhe krimin. Megjithatë, kjo nuk duhet parë si detyrë vetëm e vetë institucioneve. Suksesi nuk arrihet vetëm me një faktor. Lufta efektive kundër krimin të organizuar, dhe veçanërisht korrupsionit, kërkon gjithashtu një ndryshim në kulturën tonë sociale dhe rritje të angazhimit etik dhe civil.